




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.12.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 01.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit, të datës 15.11.2022 sipas kërkesës së Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve të datës 11.11.2022, të paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 11, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare nga kodi i participimit për subvencione në bujqësi për vitin 2022

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej 231,360.00€, prej 'Kodit të participimit, subvencioneve dhe transfereve duke e përfshirë edhe mbetjen e mjeteve financiare në shumën prej 46,272.00€, nga participimi i fermerëve në vitin 2022, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2022 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 35,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 70,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut';
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 5,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Spërkatësve për traktorë';
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 108,360.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor';
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 7,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Pajisjeve bletare';
 - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 3,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mullinjëve';
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga paragrafi 1, nënparagrafët prej 1.1 e deri tek nënparagrafin 1.7, të paragrafit një të vendimit, participojnë edhe fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2022, me 20% të vlerës së projekteve.

3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRATIJU

Nr./no/Br. str. 265
Datë/Date 08.12.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



Datë: 07.12.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datën 01.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1140, të datës 22.11.2022, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkornja (f), nenin 40, paragrafi 40.2 (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (dh), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 mori.

V E N D I M

Për lejin e mjeteve financiare për marrjen e pronës me qira për ndërtimin e rrugës Miradi - Zona Industriale

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1140, të datës 22.11.2022, për lejin e mjeteve financiare për marrjen me qira të pronës së Hekurudhave të Kosovës, nga ndërmarrja publike 'Infrakos'. SH.A, për periudhën tre vjeçare, me një kosto financiare vjetore prej: 6.012.96€, për sipërfaqen e nevojshme prej: S=2238m² për 'Rikonstruimin e rrugës Miradi - Zona Industriale', projekt i financiar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësniorë dhe Infrastrukturës.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, arrijtjen e marrëveshjes për qira ndërmjet 'Infrakosit' SH.A dhe Komunës së Fushë-Kosovës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.
3. Mbetet në autoritetin dhe përgjegjësinë e Komunës së Fushë-Kosovës, që në kordinim me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësniorë dhe Infrastrukturës, si bartëse e këtij projekti me interes publikë dhe Infrakosin, të vazhdon qiranë apo të kryen procedurën e shpronësimit të pronës, nëse kjo punë lejohet në perimetrimin e rrugës së ndërtuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së ZHE, Infrakosit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 22.12.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 1284, të datës 19.12.2022, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, mbështetur në kërkesën e drejtuar Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve me Nr. 1273, të datës 15.12.2022, bazuar në nenin 15, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për transferimin e mjeteve financiare në kategorinë ekonomike të komunalive

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1224, të datës 19.12.2022, për lejimin e transferimit të mjeteve financiare në shumë prej: 100,000.00€ nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale me bllokun kodues me Nr. 10/312/73011/30/51385/0760 nga projekti kapital për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë - lagjia 'Italia', në kategorinë ekonomike të komunalive me bllokun kodues, me Nr. 10/612/18162/14/00000/0451, në shërbime publike/infrastrukturë publike.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Prilag./Bilstr. 280
Datë/Batum. 29.12.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 270, të datës 13.12.2022, të paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (ç), nenin 40, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1254, të datës 13.12.2022, të paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e punës në 'Shkollat Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Rregullorja për Organizimin e Punës në 'Shkollat Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Fushë-Kosovës', e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e organizimit dhe rregullimit të punës nëpër shkollat e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Organizimin e Punës në 'Shkollat Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Fushë-Kosovës'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë, Directorate of Administration. It contains the following information:

- Number/Serial: 282
- Date: 29.12.2022
- Location: KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit për Projekt-Rregulloren e Shërbimeve Publike, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të shërbimeve publike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Shërbime Publike e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 28.12.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit për Projekt-Rregulloren e Shërbimeve Publike, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të shërbimeve të varrimit në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.12.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr.1298, të datës 21.12.2022 të paraqitur nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe mbështetur në kërkesën e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë me Nr.1299, të datës 21.12.2022 dhe kërkesën e përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe të Fushë-Kosovë me Nr. 1300, të datës 22.12.2022, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për periudhën janar-mars të vitit 2023

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën janar-mars të vitit 2023, me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj, në shumë të mjeteve financiare prej 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për periudhën në fjalë, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe vlenë së zbatuari për periudhën e cekur në pikën një të vendimit deri në hyrjen në fuqi, të Rregullores Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 29.12.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.12.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 444, të datës 14.12.2022, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, shkresën me Nr. 5996-2/22, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresën Nr. 0-910/2, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori: h

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 210 të datës 05.10.2022 dhe rregullores Nr. 211 të datës 05.10.2022 për bonmuse të zonimit

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 210 të datës 05.10.2022 dhe rregullores Nr. 211 të datës 05.10.2022 për bonuse të zonimit, sipas shkresës me Nr. 5996-2/22, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresës Nr. 0-910/2, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**

